Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2025

Bashkia Has



Tabela e përmbajtjes

I. Hyrje .....

II. Metodologjia e vlerësimit .....

III. Monitorimi i zbatueshmërisë të planit të integriteit .....

IV. Konkluzione dhe Rekomandime ..... Error! Bookmark not defined.

V. Hapa të tjerë.....

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e realizimit te plotë të masave/aktiviteteteve janar-dhjetor 2025.....

Figura 2; Grafiku i zbatimit të masave janar-dhjetor 2025.....

Figura 3: Objektivi I "Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.....

Figura 4: Objektivi II "Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.....

Figura 5: Objektivi III "Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.....

Figura 6: Objektivi IV "Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.....

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

I. Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit janë prioritet kryesor i Qeverisë Shqiptare. Në sektorin publik, integriteti nënkupton përmbushjen e detyrimeve për transparencë, llogaridhënie, etikë, ndershmëri, efektivitet dhe eficencë në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e funksioneve rregullatore dhe administrative.

Në qeverisjen vendore, zbatimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit konkretizohet përmes koordinimit dhe zbatimit të nismave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023, që vijon me Strategjinë e re 2025-2030 dhe Planin e Veprimit 2025-2027, të miratuara me Vendimin nr. 73, datë 09.09.2025.

Menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) është një proces i rëndësishëm, i cili mbështetet në Qëllimin e parë të Politikës: Parandalimi i korrupsionit, dhe konkretizohet në Objektivin Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces kontribuon gjithashtu në realizimin e Qëllimit Politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore "Forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor", Objektivi Specifik 5.2: "Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin", miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023.

Ky proces është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, ku theksohet zbatimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar mungesës së një sistemi funksional për menaxhimin e integritetit në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut të integritetit në nivel vendor zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Hapi i parë është hartimi i Planit të Integritetit për njësinë vendore, i detajuar edhe me një Plan Veprimi. Monitorimi dhe raportimi i këtij plani përbëjnë fazën tjetër të menaxhimit të riskut. Monitorimi zhvillohet periodikisht (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë e tyre.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar procesin e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2025.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

II. Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar sipas metodologjisë së miratuar me **Urdhrin nr.553, datë 30.09.2021**, *"Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore"*. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet analizës së të dhënave dhe matjes së progresit në zbatimin e masave të përfshira në Planin e Veprimit për këtë periudhë raportimi.

III. Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Has për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I :** *Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;*
- **Objektivi II:** *Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;*
- **Objektivi III:** *Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;*
- **Objektivi IV:** *Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;*

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe dyvjeçare, konkretisht 2025-2027.

Për Bashkinë Has, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në mbështetje të realizimit të objektivave të planifikuara.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit Bashkia Has për periudhën janar – dhjetor 2025, rezulton si më poshtë:


Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 6 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 4 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 66% të totalit
- 1 masë/aktivitet është në process realizimi, ose 17%
- 1 masë /aktivitet nuk është realizuar ose 17%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Figura 1 : Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktiviteteteve janar-dhjetor 2025.



Bashkia Has	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Realizimi në total i objektivave të PI		6	4	1	1

Figura 2: Grafiku i zbatimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.



Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Has ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Qasja Vlerësuese.

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë për vitin 2025 ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi progresin e arritur dhe nivelin e zbatueshmërisë së aktiviteteve dhe masave të parashikuara. Ai analizon menaxhimin e riskut në fusha të ndryshme të përgjegjësisë dhe vlerëson nëse veprimet e ndërmarra janë në përputhje me kuadrin rregullator. Raporti gjithashtu shqyrton ndikimin e masave mbi performancën institucionale dhe fuqizimin e kapaciteteve për të parandaluar dhe përballuar shkeljet e integritetit, duke nxjerrë mësime për përmirësime të mëtejshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë, bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2025, sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë mbledhur nga Koordinatori i Integritetit të bashkisë, në përmbushje të rolit të tij si strukturë e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I "*Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit*".

Ky objektiv synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj


Gjatë periudhës raportues, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar 1 masë/aktivitet, dhe i cili :


- është realizuar ne masen 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete te parealizuara
Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit		1	1	0	0

Figura 3: **Objektivi I** "Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.





Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën **100%,** me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të zhvillimit të Bashkisë Has, i cili përfshin:

-politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite;

-nevojën dhe potencialet e zhvillimit vendor, si dhe prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit strategjik, duke parashikuar edhe kostot përkatësezbatimin nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë.

Objektivi II: "*Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit*".

Ky objektiv synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Bashkia angazhohet të zbatojë në mënyrë objektive Ligjin "Për shërbimin civil", i cili ofron një kuadër të sigurtë ligjor për krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 nuk janë planifikuar për t'u realizuar aktivitete.

Objektivi III: *Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;.*

Ky objektiv synon të forcojë procesin e zbatimit të politikave vendore për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Sigurimi i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioriteteve strategjike afatgjata gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore si dhe të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme Programin e Transparencës dhe faqen zyrtare të bashkisë.

Gjatë periudhës raportues, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, nga i cili:


- nuk është realizuar masë/aktivitet

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete te parealizuara
Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun		1	0	0	1

Figura 5: **Objektivi III** "Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.





Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2025, ky objektiv nuk është realizuar me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i informacionit në Programin e Transparencës mbi administrimin e pronave bashkiake (gjendja, përdorimi, të ardhurat dhe shpenzimet për administrimin e tyre).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Objektivi IV: "*Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë*";

Ky objektiv synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, efiçencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 75 %
- Janë në proces realizimi 1 masa/aktivitete ose 25 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Objektivi IV	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete te parealizuara

Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë	4	3	1	0


Figura 6: **Objektivi IV** "Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë", grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën **75%,** me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Ngritja e Njësisë së Auditit të Brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- Analizë e realizimit të objektivave të PPV-së periodikisht në kuadër të rishikimit të masave për plotësimin me burime njerëzore dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për zhvillimin e territorit në Bashkinë Has.
- Ngritja e grupit për hartimin e PDV-së me nismë publike me qëllim detajimin e përcaktimeve të PPV-së, për:
  a)zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e njësisë;
  b)rigjenerimin/ripërtëritjen urbane;
  c)përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit;
  ç) investimet publike në infrastrukturë apo shërbimet publike, që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit;d)programet e drejtimit të zhvillimit nëpërmjet instrumenteve.



VI. Konkluzione dhe Rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën janar dhjetor 2025, bazuar në të dhënat e raportuara nga strukturat përgjegjëse dhe analizën e realizuar, rezulton se:

Institucioni ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 65 përqind të masave të planifikuara për vitin 2025. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar disa zhvillime pozitive, konkretisht:

- Forcimi i kulturës së integritetit dhe përgjegjshmërisë në administratë
- Rritja e transparencës në publikimin e akteve dhe vendimmarrjeve
- Organizimi i trajnimeve për etikën dhe parandalimin e konfliktit të interesit
- Përmirësimi i proceseve të brendshme përmes digjitalizimit të dokumentacionit

Masat e ndërmarra kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë dhe në përmirësimin e standardeve të funksionimit institucional. Dokumentet strategjike, raportet financiare dhe mekanizmat për raportimin e shkeljeve janë bërë më të aksesueshme për publikun përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

Në vijim, rekomandohet vazhdimi i zbatimit të masave të mbetura, forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe monitorimi periodik i indikatorëve të performancës, me qëllim konsolidimin e arritjeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të integritetit.

V. Hapa të tjerë:

* Të zgjerohet programi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuese, me fokus të qartë në parandalimin e sjelljeve që cenojnë integritetin dhe në forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë në administrate

* Të forcohet zbatimi i masave për transparencë dhe të rishikohet kuadri rregullator, me theks në menaxhimin financiar, burimet njerëzore dhe administrimin e aseteve publike

* Të rritet pjesëmarrja qytetare përmes krijimit dhe promovimit të kanaleve efektive dhe anonime për sinjalizim, duke garantuar konfidencialitet dhe trajtim serioz të çdo raportimi

* Të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e strategjisë për administrimin e pronave të bashkisë, me objektiva të qarta dhe mekanizma monitorimi

* Të forcohet koordinimi ndërmjet drejtorive, me qëllim sigurimin e një raportimi të rregullt, të unifikuar dhe të bazuar në tregues konkretë mbi ecurinë e masave të Planit të Integritetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS